

ARDHMËRIA E KOMBIT SHQIPTAR SIPAS AKADEMIK REXHEP QOSJES

Zeqirja REXHEPI, Zejnepe ALILI REXHEPI

Abstrakt

Shqiptarët njihen si një ndër popujt më të vjetër të Evropës, megjithatë ata u çliruan më vonë nga të tjerët. Gjatë historisë, shqiptarët kontribuan në ruajtjen e identitetit kulturor dhe politik të Evropës, por Fuqitë Evropiane, nuk i morën parasysh lutjet dhe kërkesat e shqiptarëve, as në Berlin (1878), as në Londër (1913) dhe as në Paris (1919). Shqiptarët me përpjekjet e veta e realizuan unifikimin kulturor, por nuk arritën ta vëjnë edhe unifikimin politik, sepse kjo nuk varej vetëm prej tyre, kështu mbetën të copëzuar politikisht pa formuar asnjë qendër të fuqishme administrative, politike, diplomatike, ekonomike dhe kulturore, me të cilën do të identifikoheshin tërë kombi.

Për këtë çështje ka shkruar mjaft në veprat e tij Akademik Rexhep Qosja, që midis tjerash thotë: *“E kemi mbijetuar marshin vrastar të historisë, por ka mbetur muri tragjik që e ka ndarë përgjysmë popullin tonë”*.

Fatet e popujve të vegjël, gjithnjë, i kanë përcaktuar “të mëdhenjtë”. Kështu ka ndodhur edhe me fatin e popullit shqiptar, ku padrejtësia ka qenë shumë e madhe, aq sa nikoqiri i konferencës së ambasadorëve në Londër, *Eduard Grej, më 12 gusht 1913*, duke dashur të arsyetohet para gjykimit të historisë, deklaroi: *“Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të mëdha nga kushdo që e njeht vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes së Evropës”*.

Eduard Grej, nga varri ku pushon, duhet t'i përgjigjet historisë: **A u ruajt paqja në Evropë nga sakrifikimi i shqiptarëve?**

Fjalë kyç: historia shqiptare, popull më i vjetër, marshi vrastar, muri tragjik, pikëpamje e gjykime...

Hyrje

Kur është fjala për Akademik Rexhep Qosjen, pa dyshim se është dhe do të mbetet njëri nga mendimtarët më të mëdhenj shqiptar në fundshekullin XX dhe fillim të shekullit XXI. Si rrallëkush tjetër, ka lënë gjurmë në fushën e Albanologjisë, në veçantinë fushën e Letërsisë shqipe.

Përpos shkencës së Albanologjisë, akademik Rexhep Qosja njihet edhe si mendimtar i madh – rreth temave që kanë të bëjnë me çështjet politike të kohës – fundit të shekullit XX, sidomos pas rënies së sistemit komunist. Mund të thuhet lirisht se akademik Rexhep Qosja është vazhdimësi e mendimit politik shqiptar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

###

Në veprat e tij, të karakterit politik, mendimtari madh Rexhep Qosja ia rikujton brezit të ri të kaluarën e hidhur të popullit shqiptar, duke u përpjekur ta orientojë drejt së ardhmes. Ai, në vazhdimësi na rikujton se, jemi popull evropian edhe pse historia na ka ndarë nga Evropa, por gjeografia na ka vendosur, ne si popull, në Evropë.

Në përpjekjet shekullore për të mbetur popull evropian, e për të ruajtur identitetin etnik dhe kulturor, populli shqiptar, ka harxhuar energji të mëdha.

Sipas Qoses, ritmi i zhvillimit kulturor i shqiptarëve deri në shekullin XV, pothuajse është ndërprerë nga pushtimi otoman. Ky zhvillim antihistorik, do ta vonojë zhvillimin e popullit shqiptar në të gjitha fushat, si në: ekonomi, kulturë, qytetërim, politikë, etj.

Ai na rikujton se, shqiptarët asnjëherë nuk janë pajtuar me shkëputjen nga Evropa. Dëshmi për këtë janë luftërat e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, sikurse dhe kryengritjet e vazhdueshme nga shekulli XV, e deri në shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912, ndërsa në fushën e kulturës dëshmi janë veprimtaria letrare e Marin Barletit, e Gjon Buzukut, Pjetër Budit, Pjetër Bogdanit e shumë të tjerëve.

Pra, Qosja dëshmon me fakte të pamohueshme se, populli shqiptar donte të ishte në Evropë dhe përpjekjet shekullore të këtij populli kanë qenë t'i kthehen Evropës – gjë që është dëshmuar edhe me përpjekjet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, gjatë shekullit XIX.

###

Shqiptarët do të kthehen në skenën politike dhe kulturore evropiane në shek. XIX, në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila ishte lëvizje e frymëzuar nga **ideologjia kombëtare**, e ndërtuar mbi traditat kulturore të popullit shqiptar dhe mbi idetë filozofike të iluminizmit dhe të Revolucionit të Madh Francez.

Ideologjia Kombëtare Shqiptare është koduar në Programin e Rilindjes Kombëtare, i cili pjesërisht do të realizohet në vitin 1912 dhe pjesërisht më vonë.

Akademik Rexhep Qosja, nuk heziton t'i thotë hapur edhe pengesat që kanë shkaktuar realizimin e **ideologjisë kombëtare** shqiptare. Pa as më të voglën dilemë, ka qenë islamizmi si ideologji fetare dhe komunizmi, si ideologji politike, që e largoi popullin shqiptar nga Evropa.¹ Çmimi që ka paguar populli shqiptar ka qenë shumë i lartë, çmim që do të ndihet edhe në periudhën e mëvonshme.

###

Duhet theksuar se, për shumë zhvillime të mbrapshta, përpos vetë shqiptarëve, Akademik Rexhep Qosja i fajëson Fuqitë e Mëdha Evropiane, të cilat pas krizës Lindore (1877-78), janë sjellë ndaj popullit shqiptar sikur ky popull të ishte i huaj për Evropën. Nga kjo kohë, Evropa nuk do të jetë e gatshme t'i pranojë shqiptarët në gjirin e saj.

Shtrohet pyetja, PSE?

Akademiku ynë, ndër arsyt kryesore i përmend:

-Interesat strategjike të Fuqive Evropiane;

-Fuqitë Evropiane në vazhdimësi i janë shmangur trysnisë së Rusisë, e cila kishte marrë flamurin e pansllavizmit;

-Fuqitë Evropiane mendonin se shqiptarët me konvertimin e shumicës së tyre në islam e kishin tradhtuar Evropën, apo

-Fuqitë Evropiane nuk dëshironte të bëjë dallimin midis fesë dhe kombësisë dhe myslimanët i konsideronte për turq...!

Me pëlqimin e Fuqive Evropiane (Anglia, Franca, Gjermania dhe Italia), në shek. XIX fillon copëtimi i trojeve shqiptare, në Kongresin e Berlinit (1878), në konferencën e Ambasadorëve (1913), në konferencën e Parisit (1919)...

Me “pëlqimin e heshtur” të Fuqive Evropiane, janë shpërngulur me dhunë muhaxhirët nga Serbia e Jugut, gjatë luftës Ruso-Turke të viteve 1877/78,

Me “pëlqimin e heshtur” të Fuqive Evropiane janë zhvilluar veprimet shfarrosëse të ushtrisë malaziase, të ushtrisë serbe dhe të ushtrisë greke, në vitet 1912 dhe 1913.

¹ Strategjia e bashkimit kombëtar, Instituti Albanologjik, 1992, f. 11.

Me “pëlqimin e heshtur” të Fuqive Evropiane është bërë kolonizimi i Kosovës me serbë dhe malazias;

Me “pëlqimin e heshtur” të Fuqive Evropiane është bërë Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938, për dëbimin e qindra mijëra shqiptarëve për në Turqi, projekt që ka vazhduar edhe pas Luftës së Dytë Botërore;

Para syve të Fuqive Evropiane është zhvilluar drama më e madhe në historinë njerëzore – ndaj një populli më të vjetër evropian, gjatë tërë shekullit XX.

###

Para syve të Fuqive Evropiane, në Londër (1913) sillet vendimi për ndarjen e kombit shqiptar dhe po këto Fuqi ia dhanë Kosovën Serbisë, në të cilën kishte vetëm 5 % serbë. Gjysmës së kombit shqiptar, në vend të pushtimit turk ia imponuan pushtimin serb, akoma më të egër se sa ai turk.

Në fund të këtij vendimi, sa për të shpëlarë ndërgjegjen e njollosur të tij dhe të Anglisë, ministri i jashtëm i saj, Eduard Grei do të deklarojë:

“Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të mëdha nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes së Evropës”.

Në kurriz të shqiptarëve synohej të ruhet paqja... por paqja nuk u ruajt dhe një vit më vonë, në verë të vitit 1914, të rinjtë e Fuqive Evropiane u mbytën në gjakun që e kishin shkaktuar me vendimet e tyre të padrejta.

Menjëherë pas kësaj, me rastin e caktimit të kufijve të shtetit shqiptar, Fuqitë Evropiane janë tallur me popullin shqiptar, duke caktuar një shtet i cili do të kufizohej në të gjitha anët me shqiptarë.

###

Lidhur me qëndrimin e Fuqive Evropiane akademik Rexhep Qosja thekson se, Fuqitë Evropiane i kanë dënuar shumë rëndë shqiptarët, por nuk shkoj shumë kohë ata u dënuan nga Zoti vetë, duke përjetuar tmerre të jashtëzakonshme në dy luftëra botërore - kataklizëm të paparë në historinë 2000 vjeçare.

Pas Luftës së Dytë Botërore, qendrat evropiane të vendosjes e kishin humbur fuqinë e vendosjes. Pikërisht në këtë kohë fillon një epokë e re e historisë, fillon epoka e një Evrope të Re, e cila do të bënte ndryshime në jetën e saj politike, kulturore dhe shoqërore. Ndryshimet e reja në shoqërinë evropiane, shkaktuan rënien e sistemit komunist. Kjo është koha kur Evropa fillon të interesohet edhe për çështjen shqiptare! Por, edhe gjatë kësaj kohe çështjen shqiptare, Evropa e shikon jo si çështje kolektive kombëtare, por si çështje të të drejtave të njeriut.

###

Rreth të ardhmes së popullit shqiptar, Akademik Rexhep Qosja thotë: ***Ne shqiptarët duhet ta trajtojmë çështjen tonë si çështje të një populli të ndarë – nuk mund të pranojmë që çështja shqiptare të trajtohet si çështje e pakicës kombëtare.***

Por, ndërkohë duhet rikujtuar se në nëntor të vitit 1990, në Paris, afro 1 muaj pas ribashkimit të Gjermanisë², Evropa vendosi parimin e njohur si ***Karta për Evropën e Re***, që parashikon

² Më 3 tetor 1990 u bashkuan dy shtetet gjermane.

mosndryshimin e kufijve të shteteve Parimi për mosndryshimin e kufijve vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite.

Rreth këtij parimi të vendosur në Paris, akademik Qosja thotë: *çështja për mosndryshimin e kufijve duhet të vlejë për pakicat kombëtare e jo për një popull të ndarë padrejtësisht.*

###

Është i njohur fakti se, Programi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishte program i çlirimit, i lirisë dhe i pavarësisë së popullit shqiptar, program i ruajtjes së tokave shqiptare dhe i ruajtjes së popullit tonë.

Ku jemi sot?

Fitohet përshtypje se Ne shqiptarët jemi dëshpëruar dhe jemi dorëzuar! Përderisa, përmes emigrimit masiv, jemi në kërkim të Atdheut të Ri!?

Mirëpo, duhet theksuar se përpjekjet tona për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar janë të ligjshme dhe të natyrshme.

Trojet shqiptare janë pushtuar shpesh gjatë historisë, por pushtuesit kanë shkuar, ndërsa populli shqiptar ka mbetur në trojet e veta.

Rreth besimeve fetare Qosja është realist dhe e pranon realitetin fetar! Ai thotë: Shqiptarët besojnë në tri fe dhe të triat mund ta pasurojnë kulturën shqiptare. Feja nuk qëndron mbi Atdheun, sepse Atdheu është më i lashtë se feja. Fetë janë të shumta, por Atdheu është vetëm NJË.

Sipas akademik Rexhep Qoses, **zgjidhja përfundimtare e çështjes shqiptare do të jetë bashkimi kombëtar.**